

NDËRTIMI I AEROPORTIT TË KUKËSIT

Këshilli i Ministrave miratoi nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit për “Rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit”. Punimet nisin me hyrjen në fuqi të VKM-së dhe do të zgjasin 24 muaj. Rreth 12 mijë persona do të punësohen në fazën finale të realizimit të këtij projekti ndërsa pozita e mirë gjeografike ka tërhequr vëmendjen e linjave të mëdha Low Cost. Synimi është ulja e çmimit të biletave dhe rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

RIKONSTRUKSION I DPSHTRR ELBASAN

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Elbasan ofron tashmë kushte më të mira për qytetarët të cilët paraqiten pranë sporteleve për të marrë shërbimet e kërkuara. Falë një investimi prej 40 milionë lekësh, janë rikonstruktuar mjediset e brendshme duke përmirësuar ndjeshëm hapësirat për qytetarët, por edhe për personelin e kësaj drejtorie. DRSHTRR e Elbasanit trajton mesatarisht 500 kërkesa për shërbime të qytetarëve në ditë.

INTERPELANCË ME PRODHUESIT FOTOVOLTAIKË

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku i është përgjigjur interpelancës së thirrur përmes Platformës së Bashkëqeverisjes nga përfaqësuesit e bizneseve që kanë instaluar fotovoltaike për vetkonsum. Kërkesa e këtij grupi interesi lidhej me hartimin e akteve nënligjore për miratimin e procedurës së lehtësuar për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme. Për hartimin e metodologjisë së nevojshme për këtë proces u vendos ngritja e një grupi të përbashkët pune me përfaqësues nga MIE, OSHEE dhe grupet e interesit.

STATUSI I NAFTËTARIT

Në takimin e zhvilluar në Fier me naftëtarët dhe përfaqësues të sindikatave të tyre, për të diskutuar mbi zbatimin e ligjit për “Statusin e Naftëtarit”, ministrja Balluku i siguroi ata se do të vazhdojnë të kenë vëmendjen dhe mbështetjen e qeverisë. Naftëtarët shprehën shqetësimin e tyre për problematikën që VKM 526 u krijon në plotësimin e dosjes për statusin. Ministrja Balluku i informoi ata se tashmë është vendosur rishikimi i kësaj VKM-je të hyrë në fuqi në vitin '58.

RREGULLIM TË TRANSPORTIT PUBLIK

MIE është duke punuar për hartimin e një pakete të re që ka për synim rregullimin e sektorit të transportit publik ndërqytetas dhe ndërkombëtar. Në tryezën e zhvilluar me përfaqësues të transportit publik, ministrja Balluku theksoi se paketa që do të hartohet ka për qëllim ofrimin e një shërbimi sa më të mirë për qytetarët. Numri i madh i licencave si dhe konkurrenca e pandershme ishin dy prej shqetësimeve të ngritura nga shoqatat e transportit.

SIGURIA E URAVE

ARRSH ka ndërhyrë për mirëmbajtjen dhe sigurinë e disa urave në vend. Në urat e Kirit dhe Spatharit përfundoi puna për riparimin e fugave dhe vendosjen e parmakëve anësorë ndërsa në urën e Bahçallëkut u vendosën paramakët metalikë. Në urën e Maliqit u krye ndërhyrja për rregullimin e njërës prej shpatullave.